



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 21.23.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË**  
**DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Lavdim Maxhuni (udhëheqës i ekipit), Florë Berisha-Kutllovci dhe Agim Sogojeva (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

## TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
5 Qeverisja e mirë.....	18
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	21
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	23
Shtojca III: Komentet e ministritë në gjetjet e raportit të auditimit .....	28

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në planin e Auditimit, të datës 23/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar në varësi të cilësisë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### Opinion i kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të pagesave të pagave për drejtorët e tri Qendrave Kulturore të Kosovës në Diasporë dhe Mërgatë (QKKDM) në shumën prej 65,849€, nga mallrat dhe shërbimet, derisa këto shpenzime do të duhej të paguheshin nga pagat dhe mëditjet.

Për më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



### Përgjigja e Ministrisë - auditimit 2017

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjitha të gjeturat të detajuara dhe konkluzionet e auditimit, përveç opinionit të auditimit dhe komentet për këtë mund t'i gjeni në shtojcën III.

---

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimve Strategjike (MDIS). Ne kemi analizuar veprimtarinë e MDIS-së për të vlerësuar se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste substanciale si dhe aranzhimet e qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë, me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efektit të çëshjtes së përshkruar në paragrafin e "Bazës për opinion", Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion të kualifikuar

MDIS gjatë vitit 2017 kishte paguar në emër të pagave për "drejtorët" e tri Qendrave Kulturore të Kosovës në Diasporë dhe Mërgatë (QKKDM) shumën prej 65,849€, nga mallrat dhe shërbimet, derisa këto shpenzime do të duhej të paguheshin nga pagat dhe mëditjet. Kjo ka ndodhur për shkak se drejtorët në fjalë nuk janë zgjedhur me konkurs publik dhe duke respektuar rregullat e shërbimit civil, siç kërkohet me ligjin për Diasporën dhe Mërgatën si dhe Rregulloren për zgjedhjen e drejtorit të QKKDM-së. Që nga themelimi i QKKDM-ve (në vitin 2013 në Turqi dhe 2014 në Zvicërr dhe në Suedi) drejtorët<sup>1</sup>, janë angazhuar në bazë të vendimeve me të cilat caktohen

<sup>1</sup> Në dy qendra (Turqi dhe Suedi) janë të njëjtit U.D drejtorë që nga themelimi, derisa në Zvicërr është ndërruar në 2017.

si Ushtrues Detyre, dhe pa kaluar nëpër procedurat e rekrutimit. Këto vendime nuk janë në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e zbatueshme, derisa pagesat në formën e tillë kanë rezultuar me gabim material të keqklasifikimit të shpenzimeve ndërmjet mallrave dhe shërbimeve si dhe pagave e mëditjeve në PFV, dhe për këtë arsye ne e kemi kualifikuar opinionin tonë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Sekretari i Përgjithshëm i MDIS është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të, në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale, nëse individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MDIS kërkohet që të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF.Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së Nr.03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit;
- Raportet financiare tremujore, dhe
- Raportet operative.

Në kontekst të PFV-ve nuk kemi çështje për të ngritur. Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike i ka dorëzuar PVF-të brenda kornizës kohore. Të njëjtat nuk përmbanin gabime. Prandaj, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Edhe për kërkesat tjera për raportim nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e përmendur te baza për opinion të kualifikuar jepet rekomandimi:

**Rekomandimi 1** Ministri duhet të sigurojë që është bërë një analizë detale e shkaqeve që kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit. Në një afat të arsyeshëm kohor duhet të merren veprimet për ti rekrutuar drejtorët e QKKDM-ve në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që të njëjtit të futen në listën e pagave dhe të paguhen nga kategoria adekuate e shpenzimeve.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Përkundër faktit se MDIS ka vendosur kontrole relativisht të mira në raport me obligimet statutores të saj, menaxhimi financiar dhe kontrolli duhet të dëshmojnë proces më të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit.

Megjithatë, auditimi ynë ka vërejtur disa dobësi në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin e cila përfshinë kryesisht mbulimin e pozitive me UD më gjatë se tre muaj, mungesën e monitorimit të subvencioneve, mos mbylljen e avanceve brenda afatit të përcaktuar ligjor si dhe respektimin i procedurave të prokurimit.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	1,626,562	1,525,029	1,314,023	1,752,549	1,531,203
<b>Granti i Qeverisë -Buxheti</b>	1,626,562	1,525,029	1,314,023	1,752,549	1,531,203

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 101,533€. Ky zvogëlim është rezultat i shkurtimeve buxhetore që janë bërë me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2017, MDIS kishte shpenzuar 86% të buxhetit final. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kemi një realizim më të ulët të buxhetit për rreth 14%. Realizim të ulët të buxhetit kishte veçanërisht tek mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale si dhe subvencionet dhe transferet.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,626,562</b>	<b>1,525,029</b>	<b>1,314,023</b>	<b>1,752,549</b>	<b>1,531,203</b>
Pagat dhe Mëditjet	478,748	479,350	479,350	476,868	424,884
Mallrat dhe Shërbimet	992,314	901,179	715,636	1,135,696	969,212
Shërbimet komunale	25,500	14,500	8,787	9,985	9,718
Subvencionet dhe Transferet	130,000	130,000	110,250	130,000	127,389

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte për 602€ më i madh se buxheti fillestar. Realizimi i buxhetit në këtë kategori të shpenzimeve ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 91,135€ në krahasim me buxhetin fillestar. Ky zvogëlim ishte bërë me Vendim të Qeverisë, në emër të kursimeve buxhetore. Pavarësisht kësaj, vetëm 79% e buxhetit final ishte shpenzuar.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte zvogëluar për 11,000€ në krahasim me buxhetin fillestar. Edhe ky zvogëlim ishte bërë me Vendim të Qeverisë në emër të kursimeve buxhetore, dhe se realizimi i buxhetit ishte 61%; dhe
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me atë fillestar nuk kishte ndonjë ndryshim, ndërsa shpenzimi për këtë kategori ekonomike ishte 85% e buxhetit.

## Çështja 2 – Realizimi i buxhetit

**E gjetura** Realizimi i buxhetit të mallrave dhe shërbimeve si dhe shërbimeve komunale ishin sfida kryesore me të cilën është përballur MDIS. Për vitin 2017 ishin shpenzuar për mallra dhe shërbime 79% e buxhetit, ndërsa për shërbime komunale ishin shpenzuar vetëm 61% e buxhetit. Derisa te subvencionet dhe transferet realizimi ishte në shkallën rreth 85% të buxhetit. Arsyet për një shpenzim të tillë janë: vonesat në rishikimin e buxhetit, pastaj ishte paraparë hapja edhe e tri qendrave kulturore tjera në diasporë mirëpo kjo nuk ishte realizuar, nga subvencionet dhe transferet ishte planifikuar që të angazhohen ekspert të jashtëm nga diaspora, mirëpo nuk janë përzgjedhur për shkak se kërkesat janë bërë me vonesë, etj.

**Rreziku** Ekzekutimi i buxhetit në nivel jo të kënaqshëm, rezulton me shfrytëzim joefikas të burimeve të MDIS, dhe është tregues i planifikimit të dobët të buxhetit nëpër këto kategori ekonomike.

**Rekomandimi 2** Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore të monitorohet në baza të rregullta mujore. Poashtu duhet të merren veprime korigjuese për të adresuar shkaqet dhe barrierat që ndikojnë në nivelin e ulët të realizimit të buxhetit.

## 3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes sistemit të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MDIS-së, të cilat ndërlidhen me përcaktimin e koeficientëve të pagave, aprovimin e shtesave etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e aplikueshme. Në këtë kategori të shpenzimeve ishin shpenzuar 479,350€ apo 100% e buxhetit final. Testimet tona nuk kanë evidentuar ndonjë mangësi në këtë fushë.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.3 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjet në vijim:

### Çështja 3 – Mungesa e vlerësimit të performancës së stafit

<b>E gjetura</b>	Bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të Rregullores Nr.19/2012 për Vlerësimin e rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë, kërkohet që stafi të nënshtrohet vlerësimit vjetor të performancës. Në bazë të shqyrtimit të dosjeve personale ne kemi vërejtur se 14 nëpunës civilë nuk ishin vlerësuar për vitin 2017, nga to, tri pozita të kategorisë profesionale dhe 11 pozita të nivelit drejtues. Vlerësimi nuk është kryer edhe përkundër kërkesës së vazhdueshme të udhëheqësit të personelit.
<b>Rreziku</b>	Mungesa e vlerësimit të performancës së nëpunësve civil, shkakton mungesë të informatave të menaxhmentit të lartë në lidhje me performancën e stafit dhe me nevojën për trajnimet eventuale për të cilat stafi mund të kenë nevojë.
<b>Rekomandimi 3</b>	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme, që vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil të bëhet sipas dispozitave ligjore.

---

### 3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 915,679€. Prej tyre ishin shpenzuar 724,423€. Ato kanë të bëjnë me furnizime të ndryshme për zyre, servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, furnizim me mobile, furnizim me tonera, etj.

---

#### Çështja 4 - Ndarje jo e duhur e detyrave të punës

- E gjetura** Me Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik përcaktohet se një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit. Ne kemi vërejtur se në procesin e prokurimit për "Shërbimet të skenës, ndriçimit, zërimit për aktivitetet e ditëve të diasporës" në vlerë 3,500€, zyrtari i njëjtë i kishte përgatitur specifikat teknike dhe kishte marrë pjesë në komisionin për vlerësim të tenderit.
- Rreziku** Ndarja jo e duhur e detyrave përgjatë procesit të prokurimit rrit rrezikun që të ketë favorizime të ndonjë operatori ekonomik të caktuar, dhe e zvoglon trajtimin e barabartë dhe transparencën e institucionit.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj se do të ketë ndarje të duhur të detyrave të punës gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që zyrtarët që i kanë përgatitur termat e referencës/specifikimet teknike të mos të marrin pjesë në vlerësimin e ofertave.

**Çështja 5 – Mos mbyllja e avanseve dhe mbyllja e avanseve me vonesë**

**E gjetura** Neni 8 i UA 2004/07 për udhëtime zyrtare specifikon se: avanset duhet të mbyllën 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar. MDIS kishte paraqitur në PFV, katër avanse të pambyllura me vlerë të përbashkët 7,218€. Këto avanse kishin mbetur të hapura për shkak të neglizhencës së zyrtarëve që kanë udhëtuar, të cilët nuk i kanë paraqitur dëshmitë dhe nuk janë barazuar me departamentin e financave pas kthimit nga udhëtimi.

Më tutje kemi identifikuar edhe tri raste-avanse të cilat nuk ishin mbyllur brenda afatit të parapar ligjorë me shuma 6,220€, 1,311€, dhe 678€. Vonesat ishin nga 15 deri në 200 ditë.

**Rreziku** Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve dhe mos-mbyllja e avanseve, rrit rrezikun që mjetet të jenë përdorur në kundërshtim me qëllimet e synuara dhe me rregullat e aplikueshme.

**Rekomandimi 5** Ministri duhet të siguroj se i gjithë stafi i cili qëndron për vizita, seminare etj, jashtë vendit, pas kthimit ti kryejnë obligimet ligjore për arsyetimin e shpenzimeve dhe mbylljen e avanseve, në pajtim me rregullat në fuqi.

**Çështja 6 – Angazhimi me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit**

**E gjetura** Sipas Ligjit për Shërbimin Civil, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Ne kemi vërejtur se MDIS gjatë vitit 2017 kishte angazhuar 12 persona me marrëveshje për shërbime të veçanta, ku procedurat e rekrutimit për nëntë pozita ishin zhvilluar pas kalimit të afatit prej gjashtë muaj. Përmes procedurave të thjeshtuar të rekrutimit, të njëjtit janë angazhuar me MSHV edhe për gjashtë muaj të tjerë. ndërsa për tri pozita, nuk janë udhëhequr fare procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit.

**Rreziku** Angazhimi i punonjësve me marrëveshje për shërbimet e veçanta duke anashkaluar procedurat e rekrutimit, minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

**Rekomandimi 6** Ministri duhet të inicojë një rishikim gjithëpërfshirës për të përcaktuar saktë nevojat për staf, me qëllim që të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt. Në rast se shfaqet nevoja për të angazhuar staf për kohë të shkurtër, atëherë duhet të zhvillohen procedurat konform dispozitave ligjore.

---

## 3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte në vlerë 130,000€. Prej tyre ishin shpenzuar 110,250€. Mjetet ishin shpenzuar kryesisht për aktivitete kulturore, derisa testimet tona kanë nxjerrë në pah mangësitë në vijim:

---

### Çështja 7 - Monitorim i dobët i subvencioneve dhe mungesa e raporteve nga ana e përfituesve

**E gjetura** Rregullorja nr.01/2017 për kriteret dhe mënyrën e subvencionimit të projekteve për Diasporën, përcakton që përfituesi i projektit obligohet ti përmbushë në tërësi obligimet e parapara me marrëveshjen për subvencionim, derisa Marrëveshjet për Subvencionim, obligojnë përfituesit që në afat prej 30 ditësh nga përfundimi i projektit, t'i dorëzojnë zyrtarit monitorues, raportin e detajuar të kryerjes së obligimeve të parapara me marrëveshje së bashku me faturat përcjellëse.

Në katër raste përfituesit e subvencioneve nuk kishin raportuar brenda afatit të përcaktuar. Vonesat varionin deri në katër muaj, derisa vlera e përbashkët e këtyre projekteve ishte 7,950€.

Po ashtu, në pesë raste tjera me vlerë të përbashkët prej 10,100€, nuk ishin ofruar dëshmi (raporte) kthyesë nga ana e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve që janë dhënë nga ministria.

**Rreziku** Vonesat në raportimin dhe arsyetimin e subvencioneve rrezikojnë që MDIS të mos jetë e informuar në kohë lidhur me zhvillimin e projekteve të cilat i ndihmojnë në arritjen e objektivave të saj. Po ashtu, mungesa e raporteve nga ana e përfituesve për arsyeshmërinë e shpenzimeve, nuk ofron sigurinë se fondet janë shfrytëzuar sipas projekt propozimeve dhe qëllimit të ndarjes së subvencioneve. Këto vonesa rrisin rrezikun që mjetet të përdoren për qëllime të tjera.

**Rekomandimi 7** Ministri duhet të sigurojë se departamentet përkatëse mbikëqyrin dhe raportojnë në formë të detajuar dhe pagesat përcillen me dëshmi të mjaftueshme dhe adekuate, në mënyrë që të sigurohet që subvencionit po shpenzohet sipas qëllimit të dedikuar.

### 3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PVF-të e MDIS-së për vitin 2017 janë prezantuar 42,706€ pasuri kapitale (me vlera mbi 1,000€) dhe 63,802€ pasuri me vlerë nën 1,000€. Auditimi ynë ka identifikuar çështjet në vijim:

#### Çështja 8 – Mangësi në menaxhimin e pasurive

**E gjetura** Neni 4.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare përcakton se “ Zyrtaari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare”. Ne kemi vërejtur se MDIS nuk kishte procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë.

Përveq kësaj, MDIS kishte kryer inventarizimin e pasurive për vitin 2017, mirëpo raporti i inventarizimit nuk ishte harmonizuar me regjistrat e pasurive. Si rezultat i kësaj nuk mund të marrim siguri se gjendja e pasurive e prezantuar në PVF është e saktë dhe e drejtë.

**Rreziku** Mungesa e procedurave të brendshme për evidentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj në cilësinë e menaxhimit të pasurive të Ministrisë. Mos harmonizimi i gjendjes reale të pasurive të identifikuar përgjatë inventarizimit, me regjistrat e pasurive mund të ndikojë që menaxhmenti të mos i ketë informatat e sakta rreth pasurive. Rrjedhimisht informatat e shpalosura në PVF mund të mos jenë të sakta.

**Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë që menaxhimi i pasurive të bëhet në pajtim me kërkesat aktuale ligjore. Duhet të aprovohen rregullat dhe procedurat e brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013. Poashtu duhet të bëhet harmonizimi i gjendjes së pasurive mes regjistrave të pasurisë dhe raportit të inventarizimit të pasurive në mënyrë që pastaj të bëhet prezantimi i drejtë i informatave në PVF.

### 3.7 Obligimet e papaguara

MDIS, ka shpalosur obligimet e papaguara në PVF-të për vitin 2017 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013/MF për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore. Vlera e obligimeve të shpalosura në PVF-të e vitit 2017 ishte 4,416€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Në raport me vitin 2016, MDIS ka treguar progres në menaxhimin e faturave të papaguara, duke reduktuar obligimet në fund të vitit 2017 (obligimet e papaguara në fund të vitit 2016 ishte 9,040€).

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



---

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 kishte rezultuar me 11 rekomandime. MDIS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në përfundim të auditimit tonë për vitin 2017, pesë rekomandime ishin zbatuar, një ishte në proces dhe pesë të tjerat nuk ishin zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe shtatë rekomandime (tri të pa zbatuara dhe katër në zbatim e sipër). Gjatë vitit 2017 katër nga këto rekomandime ishin në proces të zbatimit derisa tri tjera nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 9 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

**E gjetura** Edhe pse menaxhmenti kishte bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimeve ende nuk kishte arritur që ti adresoj në nivelin e kënaqësishëm kjo për shkak të mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar.

**Rreziku** Mos adresimi i rekomandimeve të viteve paraprake ndikon në vazhdimin e dobësive në kontrollet e brendshme duke rezultuar në:

- Vonesa në mbylljen e avanseve;
- Vazhdimi i mbulimit të pozitive me UD; dhe
- Monitorim i dobët i shpenzimeve të subvencioneve dhe mungesa e raporteve nga ana e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

**Rekomandimi 9** Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

---

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve të brendshme, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e Zyrtarit Kryesor Administrativ me auditimin e brendshëm dhe menaxhimin e mirë të pasurisë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për ti përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohen nga të gjitha OB-të, e të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MDIS ka shënuar progres në qeverisje, duke bërë disa përmirësime në sistemet e kontrollit të brendshëm, ku kishte themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Megjithatë, janë disa fusha ku nevojiten veprime përmirësuese. Monitorimi i subvencioneve, mbyllja e avanseve mbrenda afatit të paraparë ligjorë pastaj mbulimi i pozitave me UD më gjatë se tre muaj, vlerësimi i stafit sipas procedurave ligjore, menaxhimi i pasurive, respektimi i procedurave të prokurimit, adresimi i plotë dhe cilësor i rekomandimeve tona mbesin ende sfidë për MDIS-në. Auditimi i Brendshëm edhe pse ishte themeluar në gjysmën e dytë të vitit 2017 kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre, por kjo duhet të mbështetet edhe me veprime korrigjuese nga ana e menaxhmentit.

Ministria ka hartuar Strategjinë për Diasporë dhe Mërgatën (2013-2018). Implementimi i kësaj kërkon kontrolle të brendshme efikase dhe respektim të procedurave ligjore. Prandaj nevojitet përkushtim maksimal i menaxhmentit për ti arritur synimet dhe objektivat e përcaktuara.

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

MDIS me datë 19.07.2017 ka themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) konform udhëzimit administrativ nr 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

NjAB kishte përgatitur një plan ad-hoc për vitin 2017 dhe kishte paraparë dy auditime, të cilat i kishte përfunduar të cilat kishin mbuluar aktivitetet e menaxhimit të pasurive dhe personelit, të vitit aktual.

Vlerësimi ynë është se edhe pse kjo njësi ishte themeluar në gjysmën e dytë të këtij vitit, dy raportet e përfunduara ishin cilësore dhe menaxhmentit i kishin ofruar pasqyrë të qartë mbi mënyrën e operimit të kontrolleve të brendshme në fushat e audituara, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm.

MDIS poashtu ka themeluar edhe komitetin e auditimit (KA), i cili për një kohë të shkurtër kishte mbajtur tri takime. Në këto takime është diskutuar kryesisht për planin strategjik dhe atë vjetor të cilat edhe ishin miratuar nga KA.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti duhet të zbatojë një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Menaxhmenti i MDIS ka dizajnuar sisteme relativisht të mira të kontrollit të brendshëm<sup>3</sup> dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies.

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara me procedurat e MFK-së dhe rregullës 01/2010 kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv, operacional dhe strategjik.

<sup>3</sup> Për qëllime të auditimit të PVF-ve, ne nuk kemi arritur të marrim mbështetje në kontrollet e brendshme për shkak se ato nuk i kanë adresuar plotësisht pohimet e auditimit.

---

**Çështja 10 - Menaxhimi i rreziqeve**

**E gjetura** Sipas rregullave të MFK-së, MDIS duhet të vendos procedura për menaxhimin e rreziqeve. Këto procedura duhet të përfshijnë një regjistër të rreziqeve që potencialisht kërcënojnë arritjen e objektivave strategjike, si dhe planin për menaxhimin e rreziqeve. Megjithatë MDIS nuk ka arritur që ti vendos këto procedura përkundër faktit që ne kishim rekomanduar në raportin e auditimit për vitin 2016.

**Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut mund të reduktojë cilësinë e aktiviteteve të realizuara pasi që rreziqet nuk adresohen në kohën e duhur, për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve parandaluese në kohë për të evituar ndikimin e tyre.

**Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë vendosjen e procedurave formale për menaxhimin e rreziqeve, në pajtim me kërkesat e MFK-së. Si fazë fillestare duhet të hartohet regjistri me rreziqet potenciale të cilat kërcënojnë arritjen e objektivave të ministrisë. Më tej duhet të hartohet plani për menaxhimin e rreziqeve i cili përfshin masat që do të ndërmerren për zbutjen e rreziqeve. Përveq kësaj plani për menaxhimin e rreziqeve duhet të monitorohet në baza të rregullta tremujore dhe rezultatet duhet ti komunikohen menaxhmentit të lartë.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është monitoruar në mënyrë formale dhe zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve.		Plani nuk ishte rishikuar formalisht, megjithatë disa nga rekomandimet ishin zbatuar.	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit, posaçërisht në fushën e menaxhimit të rrezikut. Të sigurohet se gjatë procesit të hartimit të strategjisë së re fillimisht të sigurohen fonde pastaj të vazhdohet me aprovim të strategjisë.			Nuk është zbatuar.
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për hartimin e listës për menaxhimin e rrezikut tek pozitat përkatëse me një monitorim nga ana e ZKA-së.			Nuk është zbatuar.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, ku secili menaxher monitoron dhe raporton për aktivitetet në drejtim të objektivave dhe buxhetin e ndarë për njësinë relevante.		Pjesërisht është implementuar ky rekomandim. Hartohen raporte mujore nga drejtorët e departamenteve por këto raporte nuk përmbajnë ndonjë krahasim të rezultateve me objektivat.	

3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha blerjet apo shërbimet, të kontraktohen në përputhje me kërkesat e LPP-së, dhe të gjitha pagesat ekzekutohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse.	Është zbatuar.		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri të sigurojë se marrëveshjet janë nënshkruar vetëm pasi janë marrë parasysh të gjitha kërkesat ligjore për t'u arritur marrëveshje me palët e jashtme. Poashtu të gjitha pagesat të ekzekutohen në përputhje me ligjin. Kjo do të sigurojë kontroll më efektiv nga MeD dhe të ketë shërbime të cilësisë së lartë me çmime më të favorshme.		Pjesërisht ishte implementuar ky rekomandim. Nuk ka pasur pagesa në të gatshme, por vazhdon mënyra e njëjtë e pagesave për drejtorët e QKKDM-ve.	
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të siguroj se subvencionet iu ipen përfitueseve të pranueshëm të cilët i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara me rregullore të brendshme dhe këtë e dëshmojnë me dokumentacionin përkatës. Poashtu të shtojë masat e kontrollit rreth monitorimit të projekteve të subvencionuara në mënyrë që raportet nga përfituesit të jenë të rregullta.		Pjesërisht është implementuar ky rekomandim. Përfituesit e subvencioneve i kanë plotësuar kriteret por vazhdon të ketë probleme me monitorimin dhe raportet kthyes.	
3.5.1 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të rishikoj efikasitetin e procesit të vendosur për menaxhimin e subvencioneve. Vendimet për dhënie e subvencioneve të identifikojnë qartazi aktivitetet konkrete të përfitueseve për të cilat jepen ato subvencione. Kjo do të lehtësonte procesin e raportimit nga ana e përfituesëve si dhe monitorimin e tyre nga ana e Ministrisë. Gjithashtu edhe përgatitja e raporteve nga nëpunësit rreth pjesëmarrjes në aktivitetet e organizuara nga MDIS-ja do të jepte një pasqyrë të saktë rreth efektit që kanë këto lloj organizimesh.			Nuk është zbatuar.



3.6 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri të sigurojë se mbahen regjistra të plotë dhe të saktë të pasurisë jo-financiare nën 1,000€, si dhe gjendja e stokeve në depo të jetë e njëjte me raportet gjatë numërimit fizik të tyre.	Është zbatuar.		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar për përcaktimin e shkaqeve për Kualifikimin e Opinionit. Në këtë aspekt, duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet lidhur me keq deklarimet e shpenzimeve, për të siguruar një buxhetim të drejtë sipas kategorive ekonomike. Me tutje, menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim detaj të draft PVF-ve, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.	Është zbatuar.		
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është duke u monitoruar rregullisht dhe do të zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara kohore. Në fokus parësor duhet të jenë rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.		Pjesërisht i zbatuar pasi që edhe më tutje një pjesë e rekomandimeve nuk janë adresuar.	

2.2 Pyetësi i vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Ministri duhet të negociojë me MF, lidhur me trajnimin e zyrtarëve të involvuar në procesin e hartimit të regjistrit të rreziqeve, brenda një afati sa më të shkurtë kohor. Në këtë mënyrë do të finalizohet një regjistër më cilësor i menaxhimit të rrezikut, duke lehtësuar edhe procesin e monitorimit të tij. Poashtu, një rishikim rigoroz duhet të zbatohet për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit për të siguruar se është bërë adresimi i fushave me dobësi. Duhet të aplikohet një mekanizëm formal për ta konfirmuar saktësinë e vlerësimeve të dhëna në listën kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.			Nuk është zbatuar.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të siguroj themelimin e NjAB-së, e cila përmes një programi gjithëpërfshirës të punës do të inkorporonte rreziqet financiare dhe do të vlerësonte efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Përveç kësaj, ne rekomandojmë që të themelohet edhe një Komitet efektiv I Auditimit i cili duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet dhe rezultatet e NjAB-së.	Është zbatuar.		
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë se mjetet po shpenzohen për qëllimet e dedikuara bazuar në limitet buxhetore të përcaktuara për secilën nënkategori. Procesi i vlerësimit dhe planifikimit të buxhetit duhet të pasqyrojë tërë informacionin e duhur për nevojat vjetore të pritura, duke marrë në konsideratë parametrat dhe rezultatet paraprake.	Është zbatuar.		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj se janë marrë veprime për të ndërprerë praktikën e angazhimeve/rekrutimeve të tilla në mungesë të procedurave, si dhe të evitohen pagesat e tyre në kundërshtim me ligjet. Njëherit, duhet siguruar se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagat e tyre të kalojnë përmes listës së pagave.			Nuk është zbatuar.

3.2.3 Mbajtja e pozitës me ushtrues detyre përtej afatit ligjor	Ministri duhet të negociojë me MF-në, për të siguruar buxhet shtesë për paga dhe mëditje në administratë konform rregullores për sistematizimin e vendeve të punës. Me pas të zhvillohen procedurat e rekrutimit për mbulimin e pozitive të përcaktuara.			Nuk është zbatuar.
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha pagesat ekzekutohen vetëm pasi të janë marrë parasysh të gjitha kërkesat ligjore. Në këtë mënyrë do të sigurohej transparencë dhe kontroll më kualitativ i shpenzimit të parasë publike.	Është zbatuar.		
3.1.2.1 Blerja e avionbiletave pa kaluar përmes departamentit të prokurimit	Ministri duhet të sigurojë se për të gjitha blerjet për të cilat kërkohet të zhvillohen procedura të prokurimit, të kalojnë përmes Departamentit të Prokurimit.	Është zbatuar.		
3.1.2.2 Vonesat në mbyllje të avanseve për udhëtime	Ministri duhet të sigurojë se shpenzimet për udhëtime zyrtare menaxhohen në përputhje të plotë me legjislacionin. Në rast mos respektimit të afateve të merren masat e përcaktuara.			Nuk është zbatuar.
3.1.3 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të sigurojë se të gjithë zyrtarët e involvuar në procesin e dhënies së subvencioneve, të respektojnë kërkesat e përcaktuara ligjore për menaxhimin e subvencioneve. Në rast të nevojës të mbahen trajnime për stafin, për të vepruar konform kërkesave të përcaktuara. Kjo do t'i hapte rrugë një procesi më kualitativ të monitorimit të tyre.			Nuk është zbatuar.

## Shtojca III: Komentet e ministritë në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja 1: Opinioni i Auditimit.	Jo	<p>Siç ju kemi njoftuar edhe gjatë fazës së auditimit në teren, statusi i qendrave kulturore të Kosovës në diasporë, ende nuk është i zgjidhur/definuar. MDIS, ka përgatitur Projekt-Rregulloren për Strukturën, Organizimin dhe Funksionimin e Qendrave Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën, si dhe "Projekt-Rregulloren për Zgjedhjen e Drejtorit të QKKDM-ve", të cilat janë proceduar për shqyrtim dhe aprovim përfundimtar në Qeveri me datë 08.07.2013. Me datë 25.04.2014 është aprovuar "Rregullorja për Zgjedhjen e Drejtorit të QKKDM-ve", por jo edhe numri i punëtorëve në ligjin e buxhetit. Ndërsa ajo për funksionimin e QKKDM-ve ende nuk është aprovuar. Pa aprovimin e kësaj rregullore nuk do të ketë kuptim as nuk mund të gjej zbatim "Rregullorja nr. 09/2014 për zgjedhjen e drejtorit të qendrës kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën.</p> <p>Drejtorët aktual të cilët e ushtrojnë këtë detyrë, nuk hyjnë në kategorinë e shërbimit civil, dhe nuk i nënshtrohen detyrimeve të këtij ligji, pasi që nuk janë dhe nuk konsiderohen si të punësuar në institucione publike, pasi që marrëdhënia e punës së tyre nuk është e njëjtë me atë të punës në shërbimin civil, pikërisht për shkak të pamundësisë për ti zgjedhur sipas legjislacionit për shërbimin civil. Përderisa nuk është zgjidhur dhe definuar statusi i QKKDM-ve, nuk mundën me zbatua rregullat e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil dhe rregullores 09/2014 për zgjedhjen e drejtorit të qendrës kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën, pasi që zgjedhja e tyre nuk ka mundur të bëhet pa u definuar paraprakisht statusi</p>	<p>Që nga themelimi, QKKDM-të vazhdojnë të funksionojnë pa u zgjidhur statusi i tyre, dhe pa bazë të qartë ligjore. MDIS duhet të shtojë përpjekjet për të rregulluar këtë çështje, qoftë duke e amendamentuar ligjin për diasporën apo përmes harmonizimit të rregulloreve të brendshme konform ligjit, dhe përfundimisht të zgjidhet statusi i qendrave, si dhe të përcaktohet funksionimi i tyre. Nëse nuk ka kuptim zbatimin e "Rregullores nr. 09/2014 për zgjedhjen e drejtorit të QKKDM-ve, pa u aprovuar rregullorja për Strukturën, Organizimin dhe Funksionimin e QKKDM-ve, atëherë nuk mund të ketë kuptim as emërimi i UD-ve dhe as funksionimi i qendrave. Prandaj zgjidhja e kësaj çështje duhet të trajtohet me prioritet nga ana e Ministrisë.</p> <p>Është e vërtetë se drejtorët nuk hyjnë në kategorinë e shërbyesve civil, duke qenë se nuk kanë akt-emërime apo kontrata</p>

	<p>juridik i qendrave në shtetin pritës, të cilat mund ta orientojnë statusin sipas rregullave të tyre dhe orientimisht mund ta përcaktoj edhe statusin e drejtorit të qendrës. Duke pasur parasysh këtë, me qëllim të zbatimit të vendimit Nr. 05/153, datë: 25.10.2013, i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për themelimin e Qendrave Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën, MDIS ka angazhuar përkohësisht (deri në definimin e statusit të QKKDM-ve), disa drejtor në këto qendra, të cilët jetojnë dhe veprojnë në shtetin përkatës ku është hap qendra, për arsye të" ekonomizimit të shpenzimeve, duke i funksionalizuar dhe administruar ato, në mënyrë që MDIS të arrij objektivat e parapara me strategji dhe obligimeve që dalin nga ligji për diasporën dhe mërgatën. MDIS-i, në vazhdimësi ka kërkuar nga MF aprovimin e këtyre pozitave si dhe buxhetin përkatës për këtë, mirëpo kjo kërkesë nuk është aprovuar asnjëherë.</p> <p>Meqenëse tipologjia e marrëdhënies së punës së këtyre drejtorëve, nuk është e njëjtë me atë në shërbimin civil dhe nuk u nënshtrihen këtyre rregullave, por konsiderohen si ofrues të shërbimeve dhe jo të punësuar në institucione publike, MDIS është detyruar që në ndarjet buxhetore për vitin 2017 të planifikoj dhe ndaj buxhet nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve për këto shërbime. Bazuar në ligjin për buxhetin për vitin 2017 (me plotësim ndryshimin e tij), pagesa për këta të angazhuar në këto pozita, është bërë nga kategoria mallra dhe shërbime, ashtu siç është' planifikuar, dhe kërkohet për këto shërbime.</p>	<p>pune. Megjithatë, në bazë të vendimeve për emërimin si UD drejtor, ata nuk mund të konsiderohen as persona të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta. Kjo ngase në ato vendime potencohet se ata përfitojnë PAGË BRUTO prej x eurove. Sa për rikujtim angazhimi për shërbime, sipas legjislacionit në fuqi mund të bëhet për shërbime specifike dhe për periudha të shkurta e jo si në rastin tuaj për vite të tëra. Derisa edhe për angazhim të personave me marrëveshje për shërbime duhet të zbatohen disa procedura ku duhet të ketë konkurrencë. Ju nuk e keni bërë një gjë të tillë.</p> <p>Sa i përket kërkesave të vazhdueshme në MF për aprovimin e këtyre pozitave si dhe buxhetin përkatës për këto, në bazë të dëshmive që na janë ofruar MDIS ka bërë vetëm një kërkesë në vitin 2015.</p> <p>Bazuar në sqarimet më lartë, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>
--	--	---